

## Gjykata supreme

**Rasti numër:** **Plm. Kzz. 178/2016**  
**(PKR. No 1046/2013 Gjykata Themelore e Prishtinës)**  
**(PAKR 216/2015 Gjykata e Apelit)**

**Data:** **19 Dhjetor 2016**

### NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të Gjykatës Supreme Avdi Dinaj (Kryesues), Gjyqtares së EULEX-it Anna Adamska-Gallant (Raportuese), dhe Gjyqtarit të Gjykatës Supreme Nebojsa Boricic, dhe Zyrtares Ligjore të EULEX-it Sandra Gudaityte në cilësi të Procesmbajtëses, në lëndën penale kundër të pandehurve:

**N.V.;**

**E.D.;**

**N.T.;**

të akuzuar me aktakuzën e ndryshuar të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “PSRK”) PP 898-4/2012, të datës 7 nëntor 2013, dhe të ndryshuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR.Nr.1046/16, të datës 3 shkurt 2014, dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN 97/14, të datës 27 mars 2014, me veprat penale vijuese:

**N.V.: Krim i Organizuar** në shkelje të nenit 274(1), (3) dhe (7) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KPPK”); **Shpëlarje e Parave** në shkelje të nenit 32 (2)(2.1), (2.4) dhe (2.5) të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit;

**Mashtrim** në shkelje të nenit 261(1) dhe (2) të KPPK-së; **Shmangie nga Tatimi** në shkelje të nenit 63(1), (2)(2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat; dhe **Keqpërdorim i Besimit** në shkelje të nenit 269 të KPPK-së;

**E.D. dhe N.T.: Krim i Organizuar** në shkelje të nenit 274(1), (3), (4) dhe (7) të KPPK-së; **Shpëlarje e Parave** në shkelje të nenit 32 (2)(2.1), (2.3), (2.4) dhe (2.5) të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit; dhe **Shmangie nga Tatimi** në shkelje të nenit 63(1), (2)(2.1), (2.5), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

*duke vepruar pas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruara nga avokati mbrojtës S.M., në emër të të pandehurit E.D., më 16 mars 2016; nga avokati mbrojtës S.K., në emër të të pandehurit E.D., më 28 prill 2016; nga avokati mbrojtës A.B., në emër të të pandehurës N.V., më 21 mars 2016; dhe nga avokati mbrojtës A.A., në emër të të pandehurit N.T., më 22 prill 2016.*

*Pasi shqyrtimit të përgjigjes së Zyrës së Prokurorisë Shtetërore (në tekstin e mëtejme “Prokuroria”), të parashtruar më 20 korrik 2016;*

*pas pleqërimit dhe votimit më 19 dhjetor 2016;*

*sipas neneve 432, 433, 435, dhe 438(2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KPP”)*

*nxjerrë këtë*

---

**AKTGJYKIM**

---

- I. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruar nga avokati mbrojtës S.M., në emër të të pandehurit E.D., më 16 mars 2016; nga avokati mbrojtës S.K., në emër të të pandehurit E.D., më 28 prill 2016; nga avokati mbrojtës A.B., në emër të të pandehurës N.V., më 21 mars 2016; dhe nga avokati mbrojtës A.A., në emër të të pandehurit N.T., më 22 prill 2016; hidhen poshtë si të pabaza.
- II. Aktgjykimi PAKR 216/15 i Gjykatës së Apelit, i datës 9 dhjetor 2015, faqe 7, paragrafi IV përmban gabime *de minimus*, për këtë është modifikuar për tu kuptuar si vijon: “Sipas nenit 365 par. 1.5 të KPP-së, koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, përkatësisht, i kreditohet të pandehurve; për N.V. prej 12 nëntorit 2012, për F.B. prej 12 nëntorit 2012, për B.B. prej 12 nëntorit 2012, për E.D. prej 18 dhjetorit 2014, për I.F. prej 18 dhjetorit 2014 deri më 25 dhjetor 2014, dhe për N.T. prej 18 dhjetorit 2014 deri më 25 dhjetor 2014”.

## ARSYETIMI

### **I. Historia Procedurale**

1. Më 7 nëntor 2013, PSRK-ja e ngriti aktakuzën No. PP 898-4/2012 kundër N.V., N.T., E.D. dhe të pandehurve tjerë. Aktakuza më pas është ndryshuar më 3 shkurt 2014 dhe më 27 mars 2014. Aktakuza më tej është ndryshuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR.Nr.1046/16, të datës 3 shkurt 2014, dhe me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN 97/14, të datës 27 mars 2014.
2. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, më 18 dhjetor 2014, Gjykata Themelore e Prishtinës e nxori aktgjykimin e saj, me të cilin:
  - E pandehura N.V. është shpallur fajtores për veprën penale të Krimit të Organizuar sipas nenit 274 (3) të KPPK-së, në ndërlidhje me veprën penale të Shpëlarjes së Parave sipas nenit 32 (2) (2.1), (2.4) dhe (2.5) të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, lexuar në kuptim të nenit 23 të KPPK-së; dhe për veprën penale të Mashtrimit sipas nenit 261 (1) dhe (2) të KPPK-së. Ajo është

- liruar për veprën penale të Keqpërdorimit të Besimit sipas nenit 269 të KPPK-së, dhe për veprën penale të Shmangies nga Tatimi sipas nenit 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat. N.V. është dënuar me dënim të përgjithshëm prej 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim dhe një gjobë prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) Euro, e cila gjobë duhet paguar brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë. Koha e kaluar nga ajo në paraburgim, prej datës 14 nëntor 2012 i është kredituar dënimit të përgjithshëm me burgim;
- Të pandehurit E.D. dhe N.T. janë shpallur fajtorë për veprën penale të Krimin të Organizuar sipas nenit 274 (1) të KPPK-së, në ndërlidhje me veprën penale të Shpëlarjes së Parave sipas nenit 32 (2) (2.1) të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, lexuar në kuptim të nenit 23 të KPPK-së. Ata janë liruar për veprën penale të Shmangies nga tatimi sipas nenit 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën tatimore dhe Procedurat;
  - I pandehuri E.D. është dënuar me 8 (tetë) vjet burgim dhe një gjobë prej 20 000 (njëzet mijë) Euro, e cila gjobë duhet paguar brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë;
  - I pandehuri N.T. është dënuar me 4 (katër) vjet burgim dhe një gjobë prej 8000 (tetë mijë) Euro, e cila gjobë duhet paguar brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë;
  - N.V. dhe të akuzuarit tjerë janë shpallur bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për t'ia kompensuar shumën prej 1 420 255,13 Euro, palës së lënduar, përcaktimi i së cilës mund të jetë subjekt i procedurës civile;
  - E.D. me një të pandehur tjetër është shpallur bashkërisht dhe individualisht përgjegjës me N.V. dhe të pandehurit tjerë, për shumën prej 400 000 Euro, dhe N.T. për shumën prej 69 000 Euro.
3. Të gjithë të pandehurit ka parashtruar ankesa ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore, përmes avokatëve të tyre mbrojtës.

4. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin PAKR 216/15. Ankesat e avokatëve mbrojtës në emër të N.V., E.D. dhe N.T., janë aprovuar pjesërisht. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në referencë të këtyre të pandehurve, është modifikuar si vijon: sa i përket vendimit mbi ndëshkimet, si vijon:
- Vepra penale e mashtrimit e kryer nga N.V. është klasifikuar sipas nenit 335 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;
  - N.V. është dënuar me dënim të përgjithshëm prej 8 (tetë) vjet burgim dhe një gjobë prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) Euro;
  - E.D. është dënuar me 5 (pesë) vjet burgim dhe një gjobë prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro;
  - N.T. është dënuar me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe një gjobë prej 5 000 (pesë mijë) Euro;
  - Vendimi për kompensimin e palës së lënduar është modifikuar në tërësi dhe pala ë lënduar është udhëzuar që kërkesa pasurore për kompensim të çfarëdo dëmi që ka rezultuar nga krimet që i janë atribuar të akuzuarve, mund të kërkohen përmes procedurës gjyqësore civile;
  - Koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak iu kreditohet të pandehurve, si vijon: N.V. prej 12 nëntorit 2014, E.D. prej 18 dhjetorit 2014, dhe N.T. prej 18 dhjetorit 2014 deri më 25 dhjetor 2014.
5. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj aktgjyimit të nxjerrë në shkallën e parë dhe të dytë, janë parashtruar: nga avokati mbrojtës S.M. në emër të të pandehurit E.D., më 16 mars 2016; nga avokati mbrojtës S.K. në emër të të pandehurit E.D. më 28 prill 2016; nga avokati mbrojtës A.B. në emër të të pandehurit N.V. më 21 mars 2016; dhe nga avokati mbrojtës A.A. në emër të të pandehurit N.T. më 22 prill 2016.
6. Më 20 korrik 2016, Prokuroria ka parashtruar përgjigje ndaj kërkesave. Prokuroria kërkon nga Gjykata Supreme ti hedh poshtë dy kërkesat e parashtruar nga avokati mbrojtës në emër

të E.D. si të papranueshme ose të pabaza, dhe kërkesat e parashtruara nga avokati mbrojtës në emër të N.V. dhe N.T. si të pabaza.

## **II. Parashtrësit e palëve**

### *Parashtrësit e avokatit mbrojtës, në emër të N. V.*

7. Avokati mbrojtës, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit janë nxjerrë me shkelje thelbësore të procedurës penale dhe të ligjit penal. Për këtë, avokati mbrojtës kërkon nga Gjykata Supreme që ti ndryshoj ato dhe ta liroj të pandehurën N.V. nga të gjitha akuzat, apo ta anuloj në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe ta dërgon lëndën për rigjykim.
8. Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban shkelje thelbësore siç janë të përcaktuara në nenin 384 (1.2) të KPP-së në ndërlidhje me nenin 370 (7) të KPP-së, për shkak se dispozitivi është i pakuptueshëm, në kundërshtim me përmbajtjen e vet dhe me arsyetimin, dhe është i bazuar në prova selektive dhe të futura. Nuk ka arsyetim në lidhje me faktet vendimtare; arsyetimi i paraqitur është i paqartë, kontradiktor dhe i anshëm. Më tutje avokati mbrojtës pohon se propozimi i mbrojtjes për një ekspertizë financiare gjithëpërfshirëse dhe të pavarur është refuzuar pa kurrfarë arsyeje, çfarë përbën shkelje të nenit 384 (2) (2.2) të KPP-së.
9. Më tutje mbrojtja pohon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk përmban asnjë arsyetim sa i përket konfiskimit të aseteve siç paraqitet në Urdhrin PKR.Nr.1046/13 të datës 18 dhjetor 2014. Urdhri i dhënë sipas nenit 284 të KPP-së, nuk e mënjanon obligimin për të dhënë arsyetim edhe në aktgjykim gjithashtu.
10. Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore i përmban shkeljet e radhitura në nenin 385 të KPP-së, për shkak se vepra penale e Mashtrimit nuk është konfirmuar kundër N.V., dhe paraqet analizë të provave për ta mbështetur këtë pohim.
11. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk i ka paraqitur faktet plotësisht dhe qartazi. Më tutje nuk është e qartë se çfarë ishte arsyetimi në lidhje me veprat penale të mashtrimit dhe shpëlarjes

së parave apo në lidhje me pretendimet e avokatit mbrojtës sa i përket përgjegjësive të OeSD dhe MPB-së për implementimin e kontratës për pasaporta. Sipas avokatit mbrojtës, këto lëshime përbëjnë një shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale siç është e përcaktuar në nenin 384 (1.12) të KPP-së në ndërlidhje me nenin 370 të KPP-së.

12. Më tutje avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje të përcaktuara në nenin 384 (1.12) të KPP-së në ndërlidhje me nenin 277 të KPP-së dhe 385 (1.5) të KPP-së, për shkak se nuk është konsideruar që apartamenti i konfiskuar është fituar në mënyrë të ligjshme.
13. Avokati mbrojtës pretendon se Gjykata e Apelit ka dështuar ti përcaktoj elementet e veprës penale të shpëlarjes së parave. Avokati mbrojtës parashtron se një nga elementet e veprës penale të shpëlarjes së parave është origjina e kundërligjshme e parave; megjithatë, në këtë rast, në që të dyja, në dispozitiv dhe në arsyetim tregohet qartazi se origjina, qëllimi dhe destinimi i parave janë të ditura.
14. Më tutje avokati mbrojtës parashtron se Gjykata e Apelit e ka shkelur ligjin penal siç parashihet në nenin 385 (1.6) të KPP-së, gjatë kreditimit të kohës së kaluar në paraburgim ndaj dënimit. Gjykata e Apelit e ka kredituar gabimisht kohën e kaluar në paraburgim prej 14 nëntorit 2014, përderisa N.V. ka qenë në paraburgim që prej 14 nëntorit 2012.

*Parashtrësat e avokatit mbrojtës S.M. në emër të E.D.*

15. Avokati mbrojtës kërkon nga Gjykata Supreme që ta anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe ta liron E.D. nga të gjitha akuzat.
16. Avokati mbrojtës parashtron se E.D. kurrë nuk ka qenë pjesë e asnjë veprimi që ndërlidhet me shpëlarjen e parave. Më tutje avokati mbrojtës analizon provat që ndërlidhen me kompaninë e quajtur P. dhe bazën ligjore të huasë së E.D. e mori nga një i pandehur tjetër. Më tutje mbrojtja shton se qëllimi i huasë është dëshmuar nga legjenda, të cilën prokurori e ka deshifruar në tërësi; megjithatë, as Gjykata Themelore dhe as Gjykata e Apelit nuk e ka adresuar atë. Ekzistojnë prova të mjaftueshme për të treguar se huaja është shpenzuar për të investuar në restorant. Më tutje avokati mbrojtës e shpjegon natyrën e një kompanie tjetër të quajtur "Q." dhe qëllimin e huasë të pranuar nga xhirollogaria e Kompanisë "CE" të N.V..

Veprimet ligjore të kësaj kompanie janë dëshmuar me marrëveshjen e shitblerjes me shkrim për pronën e paluajtshme dhe të gjitha transferet bankare.

Parashtresat e avokatit mbrojtës S.K. në emër të E.D.

17. Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje të ligjit penale dhe shkelje thelbësore të ligjit të procedurës penale në përputhje me nenin 432 (1.1) të KPP-së. Avokati mbrojtës kërkon nga Gjykata Supreme që ti ndryshoj të dyja aktgjykimet dhe ta liroj E.D. nga të gjitha akuzat, apo ti anulon të dyja aktgjykimet dhe ta dërgon lëndën për rigjykim në Gjykatën Themelore.
18. Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje të ligjit penal siç përshkruhen në nenin 432 (1.1) të KPP-së. Mbrojtja pohon se vepra penale e shpëlarjes së parave është e natyrës së ngjashme sikurse ajo e krimit të organizuar. Në këto lloje të veprave penale, është e nevojshme të dëshmohen elementet e veprës penale të theksuar. Në lidhje me shpëlarjen e parave, vepra penale e theksuar është një shkelje e cila ka shkaktuar përfitim material. Më tutje avokati mbrojtës tregon se në këtë rast nuk është përcaktuar elementi subjektiv i veprës penale të shpëlarjes së parave. I pandehuri nuk ishte në dijeni që paratë që ai i huazoi nga të pandehurit tjerë, ishin rezultat i aktiviteteve kriminale. I pandehuri nuk ka njohuri për këto aktivitete ilegale dhe as që nuk ka pasur për qëllim ti kontribuoj atyre (*dolus directus*), dhe ai nuk ishte në dijeni që për shkak të veprimeve të tija, ai mund të ketë krijuar pasoja të ndaluara me ligj (*dolus eventualis*).
19. Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban shkelje thelbësore të ligjit të procedurës penale të dhëna në nenet 432 (1.2), dhe 384 (1.12) në ndërlidhje me 370 (7) të KPP-së, për shkak se arsyetimi i aktgjykimit është jo i plotë dhe i paqartë. Mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore thjesht i përmend faktet në aktgjykim, pas asnjë vlerësim ligjor. Për shembull, në faqen 75 të aktgjykimit, është deklaruar se kompania P. ka nënshkruar një marrëveshje për investim në lokale biznesi, dhe në faqen vijuese është deklaruar se E.D. e mori huanë prej 200 000 (dyqind mijë) Euro. Për këtë, mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore nuk ka ofruar analizë ligjore të këtyre fakteve siç kërkohet me ligj, posaçërisht që huatë nuk ishin të kundërligjshme, por thjesht të arritura pa marrëveshje me shkrim.



20. Më tutje avokati mbrojtës pohon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban shkelje thelbësore të ligjit të procedurës penale të përcaktuara në nenet 432 (1.2), dhe 384 (1.12) në ndërlidhje me 370 8) të KPP-së, për shkak se aktgjykimi nuk përmban arsyetim adekuat për ndëshkimin penal. Mbrojtja argumenton se të pandehurit është dashur ti shqiptohet një dënim më i butë.

Parashtrësat e avokatit mbrojtës në emër të N.T.

21. Avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje të ligjit penale, shkelje thelbësore të dispozitave të referuara në nenin 384 (1) të KPP-së, dhe shkelje të procedurës penale. Për këtë, avokati mbrojtës kërkon nga Gjykata Supreme që ti anulon aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, dhe ta dërgon lëndën në rigjykim. Përveç kësaj, mbrojtja kërkon që ta ndalon zbatimin e vendimit gjyqësor duke u bazuar në nenin 434 (4) të KPP-së.

22. Mbrojtja pretendon se ekzistojnë një numër i shkeljeve të ligjit penal në aktgjykimet e të dyja shkallëve:

- Gjykata Themelore i ka zbatuar gabimisht dispozitat e KPPK-së, përderisa ligji në fuqi është Kodi Penal aktual i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “KPRK”). Gjykata Themelore i ka shkelur dispozitat e nenit 3 të KPRK-së që e definojnë zbatimin e dispozitave më të favorshme duke konkluduar se KPPK ishte më i favorshëm si bazë për gjykim të lëndës aktuale. Më tutje, Gjykata e Apelit ka dështuar ta vërej shkeljen e tillë.
- Gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë e kanë shkelur nenin 2 (3) të KPRK-së, i cili thotë se në rast të dykuptimisë, definicioni i një veprë penale do të interpretohet në favor të personit që është duke u hetuar, ndjekur penalisht apo dënuar. Në lëndën aktuale, nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta apo rrethanore për të treguar se N.T. e ka kryer ndonjë vepër penale të pretenduar.
- Gjykatat e kanë shkelur nenin 17 të KPRK-së për shkak se elementet kyçe, siç janë: qëllimi dhe neglizhenca, nuk janë analizuar. Aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë nuk përmbajnë analizë të dijenisë së të pandehurit që me veprimin e tij të pranimit të një shume të caktuar të parave si hua apo borxh nga një kompani tjetër, ai mund të ketë kryer

një veprim të kundërligjshëm. Thjesht transferimi i parave nuk tregon njohurin e origjinës ilegale të parave.

- Më tutje mbrojtja pretendon se gjykatat e kanë shkelur ligjin penal për shkak se ato kanë dështuar të ofrojnë bazë për ndëshkim.

23. Më tutje, aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje thelbësore të procedurës penale.

- Mbrojtja pretendon se aktgjykimet përmbajnë shkelje të nenit 384 (1.8) të KPP-së, për shkak se janë të bazuara në prova të papranueshme. Gjykata kanë dështuar që ta përcaktojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se N.T. ka kryer ndonjë vepër penale. Ato e kanë dëshmuar vetëm faktin që N.T. e ka pranuar një hua të vogël, dhe se origjina e parave është e dyshimtë.
- Më tutje, aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje të dispozitave të nenit 383(1.12) të KPP-së, që domethënë se aktgjykimet janë nxjerrë në përputhje me dispozitat e nenit 370 të KPP-së. Aktgjykimet përmbajnë kundërshtime ndërmjet arsytimit dhe dispozitivit. Më tutje mbrojtja shton se nuk ekziston nevoja për ti elaboruar shkeljet në kërkesat aktuale, pasi që Gjykata Supreme është e obliguar *ex officio* që ti adresoj këto shkelje.

#### Përgjigjet e Prokurorit

24. Prokuroria në përgjigjen e vet kërkon nga Gjykata Supreme që ti hedh poshtë kërkesat e parashtruara nga E.D. si të papranueshme ose të pabaza, dhe kërkesat e parashtruara nga N.V. dhe N.T. si të pabaza.

*Kërkesat e mbrojtjes së ligjshmërisë të parashtruara nga avokatët mbrojtës në emër të E.D.*

25. Prokuroria pohon se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruara nga dy avokatët mbrojtës, në emër të E.D., duhet të hidhen poshtë si të papranueshme sepse dispozitat aktuale të KPP-së nuk e parashohin një mundësi për palën që të parashtrorj kërkesa të shumëfishta për

mbrojtje të ligjshmërisë kundër të njëjtit aktgjykim. Në lidhje me këtë, Prokuroria pohon se nenet 432 dhe 433 (1) të KPP-së, qartazi e përjashtojnë mundësinë e parashtrimit të dy kërkesave nga i pandehuri apo avokati i tij/saj mbrojtës ose disa avokatë, kundër të njëjtit vendim përfundimtar.

26. Prokuroria parashtron se të gjitha pretendimet e paraqitura nga avokati mbrojtës S.M. janë të ndërlidhura me përcaktimin e gabuar apo jo të plotë faktik dhe duhet të hidhen poshtë në përputhje me nenin 432 (2) të KPP-së.

27. Në lidhje me argumentet e ngritura nga avokati mbrojtës S.K. në emër të E.D., Prokurori paraqet se në ligj nuk ekziston asgjë që do të sugjeronte se veprës penale të shpëlarjes së parave i duhet një vepër penale bazike. Sipas nenit 32 të Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, elementët përbërës të veprës penale të shpëlarjes së parave janë: 1. Vet akti i shpëlarjes së parave; 2. Një nivel i caktuar i njohurisë apo dyshimit që lidhet me burimin kriminal të fondeve. Kushti i dënimit të mëparshëm apo atij paralel, është i përjashtuar shprehimisht sipas nenit 32 (4) të Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Në lëndën aktuale, Gjykata e Apelit e ka qartësuar në dispozitiv se E.D. i ka pranuar 400 000 (katërqind mijë) Euro, që kanë rrjedhë nga vepra penale e Mashtrimit, të kryer nga N.V., me qëllimin e fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësisë së parave të vjedhura. Më tutje aktgjykimi i Gjykatës së Apelit e përshkruan në detaje qëllimin e kësaj vepre penale. Kështu që janë përcaktuar të gjitha elementet përbërëse të kësaj vepre penale.

28. Më tutje Prokurori paraqet se pretendimet e avokatit mbrojtës S.K. se gjykatat nuk i kanë vlerësuar provat mjaftueshëm dhe që elementet lehtësuese ndërlidhen me përcaktimin e gabueshëm dhe jo të plotë të situatës faktike dhe për këtë duhet të hidhen poshtë.

*Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga avokati mbrojtës, në emër të N.T.*

29. Në lidhje me pretendimet e avokatit mbrojtës të N.T., Prokurori paraqet se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë e kanë zbatuar si duhet ligjin më të favorshëm. Në lidhje me këtë, i pandehuri është dënuar për veprën penale të shpëlarjes së parave, në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 32(2)(2.1) të Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Ligji tashmë ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra

penale, dhe ligji nuk është ndryshuar që prej atëherë. Përveç kësaj, neni 31 i KPPK-së dhe 31 i KPRK janë të formuluar fjalë për fjalë në mënyrë identike.

30. Më tutje, Prokurori paraqet se pretendimet se gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë kanë dështuar ti ofrojnë provat që e përcaktojnë veprën penale, qëllimin dhe rrethanat mbi të cilat është vendosur dënimi, janë të bazuara mbi mosmarrëveshjen mbi përcaktimin faktik dhe duhet të hidhen poshtë.
31. Më tutje, Prokurori deklaron se mbrojtja pretendon se dënimi i N.T. bazohet në një provë të vetme, e cila është e papranueshme; megjithatë, ajo dështon ta identifikoj se cila provë është ajo.
32. Prokurori paraqet se sipas ligjit të Kosovës, Gjykata Supreme nuk e ka për obligim *ex officio* që ti përcaktoj shkeljet, vet, në mënyrë automatike. Përkundrazi, parimi sipas nenit 436 (1) të KPP-së është që Gjykata Supreme duhet ta kufizoj veten në ekzaminimin e shkeljeve të pretenduara në kërkesë. Për këtë, ky argument duhet të hidhet poshtë si i pabazë.

*Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga avokati mbrojtës, në emër të N.V.*

33. Prokurori vënë re se shumica e argumenteve në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, tashmë janë paraqitur si baza për ankesa dhe rrjedhimisht janë hedhur poshtë nga Gjykata e Apelit. Më tutje, shumica e argumenteve janë të bazuara në përcaktimin e gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike, e cila nuk mund të jetë bazë për kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, deh duhet të hidhen poshtë.
34. Më tutje Prokurori paraqet se pohimi që arsyetimi në aktgjykime është i paqartë dhe kontradiktor, duhet të hidhet poshtë si i pabazë. Gjykata i ka adresuar në mënyrë të plotë të gjitha çështjet, dhe ka ofruar arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. Aktgjykimet dhe dispozitivat e tyre i përmbajnë të gjitha të dhënat, faktet dhe rrethanat e nevojshme, që kërkohen sipas neneve 365, 370 dhe 384 (1) të KPP-së.

### **III. Përbërja e Kolegjit**

35. Kolegji e ka përcaktuar se kjo lëndë i është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014, dhe për këtë konsiderohet si një “lëndë në procedurë e sipër” në përputhje me nenin 1A (1.4) dhe 3(1) të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me

*Mandatin e Misionit të Unionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (Ligji Nr. 05/L-103) inter alia duke e modifikuar Ligjin Nr. 03/L-053 për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (në tekstin e mëtejme: “Ligji Omnibus”). Kështu që, gjyqtarët e EULEX-it kanë juridiksion mbi këtë lëndë. sipas nenit 3.3 të Ligjit Omnibus, kolegji do të kompozohet prej shumicës nga gjyqtarët vendorë dhe i kryesuar nga një gjyqtar vendor.*

36. Kolegji vë në dukje që në lëndën aktuale, anëtarja e kolegjit Anna Adamska-Gallant ka qenë e përfshirë në lëndën kundër S.S. gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. S.S. ka qenë nja nga të bashkë-pandehurit në lëndën aktuale, dhe pronar i kompanisë R.I. Ai ka qenë i akuzuar me veprat penale të Pranimi të Mallrave të Vjedhura në shkelje të nenit 345 të KPRK, dhe Shmangie nga Tatimi në shkelje të nenit 63 (1), (2.1), (2.5) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Më 22 maj 2014, trupi gjykues nxori një vendim për ta ndarë lëndën kundër S.S., për shkak se Prokuroria dhe i pandehuri i paraqitën gjykatës një marrëveshje për pranimin e fajit. Më pastaj, është formuar një trup gjykues i ri, me Gjyqtaren Anna Adamska-Gallant në cilësi të kryetares së trupit gjykues. Më 4 qershor 2014, trupi gjykues erdhi në përfundim se marrëveshja nuk i përmbush kushtet ligjore të përcaktuara në KPP. Si pasojë, më 3 korrik 2014, lënda e S.S. është ribashkuar. Aktualisht, tre të pandehur në lëndën e ribashkuar i kanë parashtruar kërkesat e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë: N.V., E.D. dhe N.T.. Për këtë, Gjyqtarja është përfshirë në procedurën penale të ndërlidhur, por jo të njëjtën.
37. Sipas nenit 39 (2) të KPP-së, “gjyqtari do të përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të apelit apo të kolegjit të Gjykatës Supreme, nëse ai apo ajo ka marrë pjesë në procedurën e mëhershme në të njëjtën lëndë penale”. Qëllimi i kësaj dispozite është për të siguruar qasjen e të pandehurit në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ky nen zbaton një test objektiv, i cili kryesisht ka të bëjë me natyrën funksionale të përfshirjes së gjyqtarit në fazat e mëhershme të procedurës dhe mund të shpie te një dyshim objekt sa i përket paanshmërisë së gjyqtarit.
38. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme “GjEDNj”) ka arritur në përfundim se në secilën lëndë individuale duhet të vlerësohet nëse përfshirja e gjyqtarit në

procedurën penale është e një natyre dhe shkalle sa të aludoj në mungesën e paanshmërisë nga ana e tribunalit. Interpretimi aktual i nenit 39 (2) të KPP-së, e konfirmon edhe më tutje që qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë që ta shkualifikoj ndonjë gjyqtar, i cili më parë ka marrë pjesë në të njëjtën (apo të ndërlidhur) lëndë penale, nga procesi penal. Më tutje, qëllimi i ligjvënësit që mos ta shkualifikoj çdo gjyqtar i cili ka marrë pjesë në procedurën e mëhershme në të njëjtën lëndë mund të nxirret nga neni 398 (2) i KPP-së, i cili përcakton: “Gjykata e Apelit mund ta urdhëroj Gjykatën Themelore që të caktoj, sipas një sistemi objektiv dhe transparent të caktimit të lëndëve, një tjetër gjyqtar të vetëm gjykues, kryetar të trupit gjykues ose trup gjykues”. Kjo domethënë që një gjyqtar apo trup gjykues që e ka gjykuar lëndën njëherë, mund të punoj prapë në të njëjtën lëndë apo në një lëndë që ka të bëjë me të.

39. Gjykata Supreme, në Opinionin e vet Ligjor Nr. 164/2014, të datës 10 prill 2014, shtoi se interpretimi restriktiv i këtij neni do ta vinte në pikëpyetje funksionimin e sistemit gjyqësor, gjithashtu duke marrë parasysh faktin se aktualisht nuk ka gjyqtarë laik në lëndët penale më. Për këtë, thjesht fakti se një gjyqtar në gjykatën penale ka qenë i përfshirë në procedurën penale që ndërlidhet me lëndën, nuk mund merret automatikisht si justifikim i frikës për mungesë së paanshmërisë; çdo dyshim mbi paanshmërinë e gjyqtarit duke marrë parasysh nenin 39 (2) të KPP-së, do të adresohet si rast në vete.
40. Në lidhje me situatën aktuale, GjEDNj ka arritur në përfundim në disa raste se thjesht fakti që një gjyqtar tashmë e ka gjykuar të bashkë-akuzuarin në një procedurë penale të ndarë, nuk është në vetvete e mjaftueshme për të hedhur dyshim mbi paanshmërinë e gjyqtarit në lëndën pasuese.<sup>1</sup> Në këto situata është e nevojshme për ta vlerësuar nëse vendimi i marrë në lidhje me të bashkë-akuzuarin, përmban ndonjë të gjetur që në fakt e paragjykon çështjen e fajësisë të tjetrit të akuzuar në procedurën pasuese.
41. Gjyqtarja Anna Adamska-Gallant në cilësinë e kryetares së trupit gjykues në rastin kundër S.S. vlerësoi nëse marrëveshja e pranimit të fajësisë i përmbushi kushtet e parapara në KPP.

---

<sup>1</sup> *Shih* ECHR, *Kriegisch vs. Gjermani*, Vendimi sa i përket Pranueshmërisë së Aplikacionit, 23 Nëntor 2010; *Khodorkovskiy dhe Lebedev vs. Rusia*, Aktgjykim, 25 Korrik 2013; *Poppe vs. Holandë*, Aktgjykim, 24 Mars 2009; *Schwarzenberger vs. Gjermani*, Aktgjykim, 10 Gusht 2006; *Ferrantelli dhe Santangelo vs. Itali*, Aktgjykim, 7 Gusht 1996.

Ky procedim ishte i ndarë nga ai në rastin PKR 1046/13, dhe trupi gjykues nuk i vlerësoi provat që ndërlidheshin me të pandehurit N.V., E.D. dhe N.T.. Dyshimi i arsyeshëm i kryerjes së veprave penale për të cilat janë akuzuar të tre të pandehurit, nuk është adresuar, përcaktuar apo vlerësuar nga gjyqtarët shqyrtues. Nuk ekziston ndonjë kualifikim i veçantë i përfshirjes së tre të pandehurve apo i akteve të kryera nga ata, kriminale apo tjera.

42. Më tutje, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruara nga të pandehurit N.V., E.D. dhe N.T., i sfidojnë të gjeturat e aktgjykimit PKR 1046/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Aktgjykimit PAKR 216/15 të Gjykatës së Apelit, që ndërlidhen me tre të pandehurit. Asnjë nga kërkesat nuk përmend provat që ndërlidhen me S.S. apo kompaninë e tij R.I..
43. Pas marrjes parasysh si më sipër, kolegji arrin në përfundim se në rrethanat e paraqitura nuk ekziston ndonjë indikacion se gjyqtarja nuk do të jetë në gjendje për të kryer një shqyrtim të freskët ndaj kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë në rastin e ndërlidhur nuk do ta paragjykonte në asnjë mënyrë çështjen e fajësisë apo pafajësisë të akuzuarve tjerë. Për këtë, kolegji, në mënyrë unanime, ka konkluduar se rrethanat që ndërlidhen me rastin e S.S. dhe procedurën aktuale nuk hedhin dyshime të justifikuar objektivisht mbi paanshmërinë e gjyqtarës.

#### **IV. Ligji në fuqi**

44. Në lidhje me dispozitat e procedurës penale në fuqi në procedurën penale aktuale, kolegji vë në dukje se sipas nenit 540 të KPP-së, për çdo procedurë penale të iniciuar para hyrjes në fuqi të KPP (1 janar 2013), por pa asnjë aktakuzë të parashtruar, dispozitat e KPP-së duhet të zbatohen *mutatis mutandis*. Në rastin aktual, hetimi është iniciuar më 9 nëntor 2012, dhe zgjeruar më 11 nëntor 2012, 14 nëntor 2012, dhe 4 qershor 2013. Aktakuza në rastin aktual është parashtruar më 7 nëntor 2013. Për këtë, procedura penale në fuqi në këtë rast është KPP-ja që është në fuqi prej datës 1 janar 2013.
45. Në lidhje me ligjin penal në fuqi, kolegji është i vetëdijshëm mbi parimin e ligjshmërisë dhe thelbit të tij, që është zbatueshmëria e ligjit më të favorshëm siç përshkruhet në nenin 2 (2) të KPRK dhe 3 (2) të KPPK-së. Neni 11 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut (1948) jep një definicion të strukturuar shumë mirë të parimit “*Askush nuk do të konsiderohet fajtor*

*për ndonjë veprë penale për faktin e ndonjë veprimi apo lëshimi, i cili sipas ligjit kombëtar apo ndërkombëtar, në kohën e kryerjes nuk ka përbërë veprë penale. gjithashtu, nuk do të shqiptohet ndonjë dënim më i rëndë se ai që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale”.* I njëjti koncept me gati të njëjtin formulim është gjetur në disa pakte ndërkombëtare dhe rajonale për të drejta të njeriut, përfshirë Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. I dalë nga parimi i ligjshmërisë, koncepti i ligjit më të favorshëm penal është një mjet që garanton të drejtat individuale, kështu që duke u siguruar nga efikasiteti e saj, qasja dhe parashikueshmëria e ligjit penal. Aty ku ka dallime ndërmjet ligjit penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe ligjeve penale pasuese që kanë hyrë në fuqi para se është nxjerrë aktgjykimi përfundimtar, gjykata duhet ta zbatoj ligjin, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për të pandehurin.<sup>2</sup>

46. Në lëndën aktuale, Gjykata Themelore mori parasysht që veprat penale janë kryer para hyrjes në fuqi të KPRK-së. Gjykata Themelore i krahasoi veprat penale të Krimit të Organizuar (neni 283 i KPRK-së dhe neni 274 i KPPK-së), Mashtrimit (neni 335 i KPRK-së dhe neni 261 i KPPK-së), Keqpërdorimit të Besimit (neni 342 i KPRK-së dhe neni 269 i KPPK-së), dhe Pranimi të Mallrave të Vjedhura (neni 345 i KPRK-së dhe neni 272 i KPPK). Pas krahasimit të elementeve të secilës veprë penale dhe duke marrë parasysht ndëshkimet e parapara me ligj, Gjykata Themelore arriti në përfundim se ndryshimet thelbësore në ligjin penal nuk janë të favorshme për të pandehurit. Për këtë, kolegji gjen se Gjykata Themelore e Prishtinës e ka zbatuar në mënyrë adekuate parimin e ligjit më të favorshëm penal.
47. Më tutje kolegji vë në dukje se Gjykata e Apelit e ka zbatuar nenin 335 të KPRK-së ndaj veprës penale të Mashtrimit dhe jo nenin 261 të KPPK-së. Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk ka dhënë kurrfarë shpjegimi se përse është ndryshuar zbatimi i ligjit më të favorshëm siç është përcaktuar nga Gjykata Themelore. Kolegji vë në dukje se elementet e veprës penale të Mashtrimit janë identike në nenin 335 të KPRK-së dhe nenin 261 të KPPK-së; për këtë, kualifikimi ligjor i veprës penale do të ishte identik sipas të dy kodeve, sikurse edhe ndëshkimi i shqiptuar. Kështu që, kolegji nuk gjen ndonjë shkelje ndaj të pandehurit apo të drejtës së tij për një gjykim të drejtë.

---

<sup>2</sup> GJEDNJ, *Scoppola v. Italy* (nr. 2) [GC], paragrafet 103-109.



48. Më tutje kolegji vë në dukje se Ligji Nr. 03/L-196 *për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit* dhe Ligjit Nr. 03/L-222 *për Administratën Tatimore dhe Procedurat* janë miratuar para se të jenë kryer veprat penale dhe që prej atëherë dispozitat përkatëse të këtyre ligjeve nuk janë ndryshuar. Për këtë, në lidhje me këto ligje, nuk ka nevojë që të zbatohet parimi i ligjit më të favorshëm. Për këto arsye, pretendimi i avokatit mbrojtës të N.T. se Gjykata Themelore i ka zbatuar gabimisht dispozitat e KPPK-së përderisa ligji në fuqi është KPRK, është hedhur poshtë si i pabazuar.

## V. Të gjeturat e Gjykatës Supreme

### Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

49. Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës S.M. në emër të të pandehurit E.D. më 16 mars 2016, avokati mbrojtës S.K. në emër të të pandehurit E.D. më 28 prill 2016, avokati mbrojtës A.B. në emër të të pandehurës N.V. më 21 mars 2016 dhe avokati mbrojtës A.A. në emër të të pandehurit N.T. më 22 prill 2016, janë të pranueshme. Kërkesat janë paraqitur nga personat e autorizuar (neni 433 (1) i KPP- së), brenda periudhës së paraparë (neni 433 (2) i KPP-së) dhe në gjykatën kompetente. (Neni 434 (1) i KPP- së).

50. Prokuroria pretendon se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura nga dy avokatët mbrojtës në emër të E.D. duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse dispozitat e tanishme të KPP-së nuk e parashohin mundësinë që pala të parashtrijë kërkesa të shumta për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër të njëjtit aktgjykim. Në lidhje me këtë, Kolegji vëren se sipas Nenit 55 (2) të KPP- së, i pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës dhe e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit. Për më tepër, Neni 19 (28) i KPP- së tregon se kur një palë përfaqësohet nga më shumë se një mbrojtës, një dhe vetëm një mbrojtës përfaqëson palën para gjykatës ose gjatë procedurave penale. Gjersa mund të thuhet se vetëm një dokument procedural mund të parashtrijet nga disa avokatë, praktika e pranuar në Kosovë dhe nga Gjykata Supreme tregon se gjykatat kanë qenë të prira të pranojnë disa dokumente procedurale të parashtruara nga më shumë se një avokat mbrojtës në emër të të njëjtit të pandehur (*shih* Gjykata Supreme, Aktgjykimi Pml. Kzz 145/2014 i datës 8 tetor 2014, faqe 7). Kolegji mendon se një procedurë e tillë, sidomos kur i pandehuri nuk e ka caktuar mbrojtësin kryesor, përforcon

mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit për të pasur ndihmën e duhur ligjore gjatë procedurës penale. Duke pranuar këtë, Kolegji konsideron se kërkesat e paraqitura nga dy avokatët mbrojtës në emër të E.D. janë të pranueshme.

#### Shtirirja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

51. Avokati mbrojtës i N.T. thekson se aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje të dispozitave të nenit 383 (1.12) të KPP-së, që do të thotë se aktgjykimet nuk janë përpiluar në pajtim me dispozitat e nenit 370 të KPP-së. Aktgjykimet përmbajnë kundërthënie ndërmjet arsyetimit dhe dispozitivit. Mbrojtja më tej shton se nuk ka nevojë që të shtjellohen shkeljet në këto kërkesa, pasi që Gjykata Supreme është e obliguar sipas detyrës zyrtare që t'i adresojë këto shkelje.
52. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është një mjet juridik i jashtëzakonshëm i projektuar për Gjykatën Supreme për të siguruar që rastet janë trajtuar pa gabime ligjore dhe që të kujdeset për zhvillimin dhe uniformitetin e rendit juridik. Palët kanë të drejtë të kërkojnë për mbrojtjen e ligjshmërisë për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre, gjykim të drejtë dhe shqyrtim gjyqësor të garantuar me Kushtetutën e Kosovës. Neni 432 i KPP-së parashikon arsyet që duhet të identifikohen për të shqyrtuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së lejuar. Përveç kësaj, neni 376 përcakton kushtet e përgjithshme për kërkesat për mjete juridike, duke përfshirë detyrimin e palës për të përshkruar në mënyrë të qartë faktet relevante të përfshira në procesverbal, si dhe bazën ligjore të kundërshtimit apo kërkesës. Ligji mbi këtë çështje është i saktë dhe konsekuent. Kjo tregon qartë se ligjvënësi ka pasur për qëllim që të vendosë rregulla që i detyrojnë palët që t'i identifikojnë arsyet për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Çështjet që nuk janë identifikuar nga palët në përgjithësi nuk trajtohen nga Gjykata Supreme, nëse nuk përcaktohet me ligj.
53. Në këtë drejtim, ligji përcakton kufij të qartë për shqyrtim të çështjes nga ana e Gjykatës Supreme, pasi që Gjykata do ta kufizojë veten vetëm në verifikimin e këtyre shkeljeve ligjore, në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon në kërkesën e tij ose të saj (Neni 436 (1) të KPP-së). Çështja e vetme që mund të trajtohet sipas detyrës zyrtare nga Gjykata Supreme

është e përcaktuar në nenin 436 (2) të KPP-së, që tregon se kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se shkaqet, për të cilat ka marrë vendim në dobi të të pandehurit ekzistojnë edhe për ndonjërin nga të bashkakuzuarit që nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse kërkesa e tillë të ishte paraqitur nga personi i tillë.

54. Më tej, kur ligji përcakton rregullat që përcaktojnë rolin e Gjykatës Supreme në gjykimin e mjeteve të jashtëzakonshme, ajo nuk vendos asnjë rregull që lejon palët t'ia delegojnë Gjykatës Supreme detyrimin e tyre për të identifikuar shkeljet e mundshme të ligjit. Kjo është një përgjegjësi që iu është dhënë ekskluzivisht palëve. Kjo siguron pavarësinë e Gjykatës dhe barazinë e palëve, të cilat janë tipare të pandara të një gjykimi të drejtë.
55. Prandaj, kërkesa e mbrojtësit të N.T., që Gjykata Supreme të identifikojë shkeljet specifike të dispozitave të nenit 383 (1.12) të KPP-së, refuzohet si e pabazuar.

#### Meritat e rastit

#### Akuzat e vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike

56. Në fillim, Kolegji thekson se një pjesë e madhe e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë e kundërshton vlerësimin e provave nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit.
57. Veçanërisht, avokati mbrojtës i N.V. pretendon se N.V. ka përfutur nga autorizim nga OeSD-ja dhe nuk e ka mashtruar OeSD-në duke marrë shumën e 1 420 255,15 eurove. E pandehura e ka marrë pagesën në mënyrë të ligjshme dhe më pas ka investuar në mënyrë të ligjshme. Për më tepër, avokati mbrojtës, në emër të N.V. thotë se e pandehura kishte autorizim për të transferuar fondet në lidhje me kontratën për pasaporta biometrike të lidhura në mes të OeSD-së dhe MPB-së në llogaritë e saj bankare. Ajo ishte përfaqësuese e autorizuar e OeSD-së që të merrej me zbatimin e kontratës.
58. Në lidhje me të pandehurin E.D., avokati mbrojtës pretendon se ka prova të mjaftueshme për të treguar se ai e kishte marrë kredinë nga një i pandehur tjetër dhe e kishte përdorur atë për

investimin në restorantin e quajtur P. dhe në kompaninë e quajtur "Q.". Mbrojtja pretendon se ka mjaft prova për të provuar se këto veprime ishin të ligjshme. Fakti se nuk ka marrëveshje të shkruar për dhënien e një kredie, nuk e bën atë të paligjshme. Në lidhje me N.T., avokati mbrojtës pretendon se nuk ka prova të drejtpërdrejta apo rrethore që tregojnë se i pandehuri e ka kryer veprën e dyshuar penale. I pandehuri thjesht ka marrë një kredi të vogël dhe ka bërë transfere bankare pa ndonjë qëllim keqdashës.

59. Në këtë drejtim, në bazë të nenit 432 (1) të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ose një tjetër shkelje e dispozitave të procedurës penale, nëse shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Neni 432 (2) i KPP-së në mënyrë rigoroze dhe në mënyrë të qartë tregon se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike. Një mospajtim i thjeshtë me vlerësimin faktik të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk përmbledhet me kushtet për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ashtu siç është përcaktuar në nenin 432 (1) të KPP-së. Për më tepër, të gjitha këto akuza janë ngritur në ankesat e të pandehurve dhe janë trajtuar gjerësisht në Gjykatën e Apelit në Aktgjykimin e saj PAKR 216/15 (shih paragrafët 75 deri në 85 të Aktgjykimit PAKR 216/15). Prandaj, Kolegji konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

60. Mbrojtja më tej pretendon se aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit janë të bazuara në prova të papranueshme. Kolegji konstaton se këto pretendime janë të lidhura me vërtetimin e gjendjes faktike në këtë rast. Mbrojtja nuk ka treguar se cilat prova ata i konsiderojnë të papranueshme ose bazën ligjore për kërkesën e tillë. Prandaj, Kolegji konstaton se të gjitha akuzat në lidhje me bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk duhet të trajtohen në këtë aktgjykim.

*Dispozitivi i pakuptueshëm dhe kundërshtues dhe kundërshtitë në mes të dispozitivit dhe arsyetimit.*

61. Mbrojtja e N.V. dhe N.T. pohojnë se dispozitivët e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit janë të pakuptueshme dhe në kundërshtim me përmbajtjen e arsyetimit,

dhe janë të bazuara në prova selektive dhe të futura dhe për këtë arsye janë në shkelje me dispozitat e nenit 370 të KPP-së. Mbrojtja e N.V. pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk specifikon se cilat prova konsiderohen të konfirmuara; arsyetimi është plotësisht i paqartë, kontradiktor dhe i njëanshëm. Për më tepër, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është në kundërshtim me arsyetimin, sepse dispozitivi thotë "*N.V. e ka mashtruar MPB-në dhe OeSD-në përmes një prezantimi të rremë për të transferuar në numrin e llogarisë bankare <...>*", ndërsa arsyetimi thotë "*çështja është nëse MPB-ja ishte fajtorë për shkak se ajo e bëri pagesën apo OeSD-ja për dhënien e autorizimit të pandehurës N.V.*". Mbrojtja e N.T. pretendon se ka përplasje të ndryshme dhe paqartësi në lidhje me dispozitivin dhe arsyetimin në aktgjykimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë; megjithatë, mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme që t'i identifikojë çështjet e caktuara sipas detyrës zyrtare (kjo çështje ishte trajtuar më parë në këtë aktgjykim, paragrafët 51-55).

62. Kolegji vëren se, pretendimi se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore është në kundërshtim me arsyetimin, tashmë është ngritur në ankesën e mbrojtësit, të parashtruar në emër të N.V.. Kontradikta e veçantë është analizuar në hollësi të madhe nga ana e Gjykatës së Apelit në Aktgjykimin e saj PAKR 216/15 (shih paragrafët 59 deri në 66 të Aktgjykimit PAKR 216/ 15). Kolegji plotësisht pajtohet me përfundimin e Gjykatës së Apelit se përveç kualifikimit të veprave penale, nuk mund të gjenden kontradikta thelbësore dhe / ose mospërputhje të rëndësishme në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, ose në mes të dispozitivit dhe arsyetimit.

63. Paneli konsideron se dispozitivi i aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit janë nxjerrë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 370 (3) dhe (4) në lidhje me nenin 365 të KPP-së. Dispozitivi përmban përshkrim të plotë të veprave, për të cilat janë shpallur fajtorë apo janë liruar të akuzuarit së bashku me përshkrimin e fakteve dhe rrethanave, që tregojnë natyrën e tyre penale dhe zbatimin e dispozitave përkatëse të ligjit penal. Gjykata Themelore në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme i përshkruan faktet, që ajo i ka konsideruar si të vërtetuara apo të pavërtetuara dhe ka treguar provat, në të cilat është mbështetur gjykata gjatë nxjerrjes së aktgjykimit. Më tej, Kolegji vëren se aktgjykimi duhet të lexohet në tërësinë e saj, duke përfshirë dispozitivin dhe arsyetimin. Dispozitivi dhe

arsyetimi janë pjesë të pandashme të aktgjykimit dhe pjesë dhe / ose fjali të caktuara të aktgjykimit nuk mund të lexohen në mënyrë të izoluar.

64. Prandaj, Kolegji konsideron se dy fjali të nxjerra jashtë kontekstit nuk tregojnë kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit. Mospajtimi i mbrojtjes me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv, nuk përbën shkelje të nenit 384 (1.2) në lidhje me nenin 370 (7) të KPP-së. Për këtë arsye, akuzat e ngritura nga avokati mbrojtës i N.V. në lidhje me kontradiktat në arsyetim, dhe në mes të dispozitivit dhe arsytimit, refuzohen si të pabazuara. Më tej, Kolegji thekson se mbrojtja e N.T. nuk ka identifikuar ndonjë shkelje specifike dhe mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, dhe për këtë arsye refuzohen si të pabazuara.

#### *Refuzimi i mocionit për një ekspertizë të pavarur financiare dhe gjithëpërfshirëse*

65. Avokati mbrojtës i N.V. pretendon se mocioni i mbrojtjes për të thirrur një ekspertizë të pavarur financiare dhe gjithëpërfshirëse është refuzuar pa ndonjë arsye, e cila përbën shkelje të nenit 384 (2) (2.2) të KPP-së.

66. Kolegji vëren se mbrojtja e N.V. e kanë bërë të njëjtin pretendim në ankesën e tyre kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe ajo u trajtua nga Gjykata e Apelit. Gjykata Supreme plotësisht pajtohet me analizën e Gjykatës së Apelit që transferet janë bërë përmes transfereve bankare dhe janë vërtetuar me anë të faturave dhe prandaj Gjykata Themelore ishte në gjendje për të vërtetuar të gjitha transaksionet. Më tej, Kolegji vëren se Gjykata Themelore e ka shqyrtuar kërkesën e mbrojtjes për të emëruar një ekspert të pavarur dhe ka arritur në përfundimin se një analizë e veçantë e të dhënave financiare nuk do të ndihmojë gjykatën në arritjen e vendimeve (*shih* Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 3 korrik 2014, faqe 5, dhe 9 shtator 2014, faqe 35).

67. Kolegji vëren më tej se, në bazë të nenit 384 (2) (2.2) të KPP-së, shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Paneli vëren se ky nen duhet të lexohet së bashku me nenin 384 (1) të KPP-së, i cili i përmend shkeljet e mundshme esenciale të procedurës penale. Kjo do të thotë se pala në kërkesën e saj duhet të tregojë dy elemente të shkeljes së mundshme të procedurës penale: Së pari, cila është shkelja e pretenduar esenciale; dhe së dyti, se ajo ka shkelur të drejtat e mbrojtjes që mundësisht ka mundur të çojë në nxjerrjen e aktgjykimit të paligjshëm dhe të padrejtë.
68. Në rastin konkret, mbrojtja thjesht deklaroi se fakti që kërkesa e mbrojtjes për të thirrur ekspert financiar për të paraqitur mendimin e tij prej eksperti u refuzua, përbën shkelje të të drejtave të mbrojtjes, pa specifikuar shkelje esenciale të procedurës penale. Kolegji rithekson detyrimin e palëve për të identifikuar të gjitha bazat e mundshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të përmendura në nenin 432 të KPP-së. Është e rëndësishme që palët të paraqesin parashtresa të arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me shkeljet e mundshme të ligjit penal, shkeljeve esenciale të procedurës penale ose çfarëdo shkelje të procedurës penale, nëse shkelja e tillë ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Nuk mjafton që të paraqitet mospajtimi me aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë ose për të përsëritur parashtresat e ankesave të mëparshme. Prandaj, Kolegji konsideron se avokati mbrojtës i N.V. nuk arriti të tregojë ndonjë shkelje qenësore të procedurës penale dhe i konstaton pohimet të pa merita.

*Elementet e veprës penale të Pastrimit të Parave*

69. Avokati mbrojtës i E.D. pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje të ligjit penal, ashtu siç përshkruhet në nenin 432 (1.1) të KPP-së. Mbrojtja pretendon se vepra themelore penale e pastrimit të parave nuk është vërtetuar. Mbrojtësi i N.V. pretendon se Gjykata e Apelit nuk ka dëshmuar elementet e veprës penale të pastrimit të parave. Avokati mbrojtës pohon se një nga elementet e veprës penale të pastrimit të parave është origjina e

paligjshme e parave; por në këtë rast si në dispozitiv, po ashtu edhe në arsyetim, tregohet qartë se origjina, qëllimi dhe destinimi i parave është i njohur.

70. Kolegji thekson se termi "pastrimi i parave", përshkruan një gamë të praktikave të përdorura për të maskuar burimin e fitimeve të paligjshme dhe integrimin e tyre në ekonominë e ligjshme. Elementi material (*actus reus*) i pastrimit të parave përfshin tri elemente: (1) konvertimi ose transferimi i pasurisë, duke e ditur se pasuria e tillë buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal me qëllim të fshehjes ose maskimit të origjinës së paligjshme të pasurisë, ose dhënia e ndihmës çdo personi, i cili është i përfshirë në kryerjen e veprës penale për t'iu shmangur pasojave ligjore nga veprimi i tij apo saj; ose (2) fshehja ose maskimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë ose të drejtave në lidhje me pronën, duke e ditur se pasuria e tillë buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal; ose (3) marrja, posedimi ose shfrytëzimi i pasurisë, duke e ditur se në kohën e marrjes së pasurisë është e tillë buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal<sup>3</sup>; *Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit* gjithashtu penalizon veprat ndihmëse, të cilat përfshijnë bashkëpunimin ose komplotin për të kryer, përpjekja, ndihma dhe inkurajimi, lehtësimi dhe këshillimi për kryerjen e një vepre të pastrimit të parave. Prona në këtë kontekst përfshin çfarëdo pasurie, materiale ose jomateriale, të luajtshme ose të paluajtshme, të prekshme apo të paprekshme, dhe dokumente ose instrumente ligjore të çdo lloji, të cilat dëshmojnë të drejtën ose interesin në një pasuri të tillë.

71. Në rastin konkret, avokati mbrojtës pretendon se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk arritën të provojnë se prona (në këtë rast paratë) është pronë kriminale. Me fjalë të tjera, mbrojtja pretendon se paratë nuk janë fituar si rezultat i sjelljes kriminale. Edhe pse nuk është e nevojshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprën themelore kriminale si një nga elementet e veprës penale të pastrimit të parave, gjykata duhet të bindet që të paktën ka prova rrethore, që vërtetojnë se të ardhurat janë përftim nga sjellja kriminale. Ndryshe nga rasti i veprës penale të kimit të organizuar, nuk kërkohet që të vërtetohet se prona në fjalë është përfitim i një veprimi të veçantë ose specifik i sjelljes kriminale, pasi që një interpretim

---

<sup>3</sup> Shih Nenin 32 (2) (2.1), (2.4) të Ligjit Nr. 03/L-196 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit; Neni 23 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2003).



i tillë do të kufizojë fushën e legjislacionit. Gjykata duhet të vërtetojë me prova të mjaftueshme rrethanore ose prova të tjera, nga të cilat mund të nxirren konkluzione në standardin e kërkuar penal, që prona në fjalë ka origjinë kriminale. Në këtë drejtim është e nevojshme për të treguar ekzistencën e një veprë penale, dhe për të krijuar një lidhje në mes të pronës që pastrohet dhe sjelljes kriminale.

72. Në rastin konkret, Kolegji është i bindur se ekzistenca e veprës penale është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata Themelore ka konstatuar se pas kontratës së tenderit të nënshkruar më 17 qershor 2011, MIA kishte transferuar në llogarinë C.B.E. 3 361 283,25 euro. Shuma prej 1 941 028,12 euro u transferua më pas nga llogaria e C.B.E.-së tek OeSD-ja, duke lënë bilancin prej 1 420 255,13 eurove. Shuma e fundit asnjëherë nuk iu transferua OeSD-së; për këtë arsye, Gjykata Themelore ka konstatuar se ajo është përvetësuar në mënyrë të paligjshme. Gjykata ka paraqitur një analizë të detajuar në lidhje me rolin e të pandehurës N.V., si përfaqësuese e OeSD-së, marrëveshja e tenderit dhe transferimet e mëvonshme të shumave të ndryshme nga MPB-ja dhe nga N.V. (*shih* faqet 106 deri në 153 të Aktgjykimit PKR. Nr. 1046/ 13). Për më tepër, Kolegji konsideron se Gjykata Themelore e gjeti lidhjen midis transferimit të parave të përvetësuara në mënyrë të paligjshme dhe të pandehurit E.D. dhe N.T.. I pandehuri E.D., si person i autorizuar për menaxhimin e kompanisë P. SHPK, ka marrë shumën prej 200 000 eurove dhe si pronar i kompanisë Q. L.B.K. SHPR, ka marrë shumën prej 200 000 eurove. I pandehuri N.T., si përfaqësues i N.B. ka marrë një shumë prej 69 000 eurove. Gjykata Themelore gjerësisht e ka analizuar lidhjen midis N.V., e cila i kishte bërë transferet në kompanitë e sipërpërmendura dhe të pandehurit E.D. dhe N.T. (*shih* faqet 124 deri në 132 dhe 135 deri në 139 të Aktgjykimit PKR. Nr. 1046 / 13).

73. Për më tepër, çështja e elementeve të vërtetuara të veprës penale të pastrimit të parave, gjithashtu ishte trajtuar edhe nga Gjykata e Apelit, e cila arriti në përfundimin se shkalla e parë i ka konstatuar në mënyrë të saktë elementet ligjore të veprës penale të pastrimit të parave në përputhje me nenin 32 (2) (2.1) të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (*shih* paragrafin 100 të Aktgjykimit PAKR 216/15).

74. Avokati mbrojtës i E.D. më tej tregon se nuk është vërtetuar elementi subjektiv i veprës penale të pastrimit të parave. I pandehuri nuk ishte në dijeni se paratë, që ai i kishte huazuar nga të pandehurit e tjerë, ishin burim i aktiviteteve kriminale. I pandehuri nuk ishte në dijeni në lidhje me këto aktivitete të paligjshme dhe nuk kishte për qëllim të kontribuojë për ta (*dolus directus*) dhe ai nuk ishte në dijeni, se për shkak të veprimeve të tij, ai mund të krijonte pasoja të ndaluara (*dolus eventualis*). Mbrojtja e N.T. shton se transferimi i thjeshtë i parave nuk tregon se i pandehuri ka pasur njohuri rreth burimit të paligjshëm të parave.
75. Përveç vërtetimit të elementeve materiale të pastrimit të parave, gjykata duhet të vërtetojë gjendjen shpirtërore të pastruesit të parave (d.m.th. qëllimin kriminal). Në përcaktimin e elementin mendor për veprën penale të pastrimit të parave, gjykata duhet të mbështetet në rrethanat faktike objektive që të nxjerrë nga ata elementin mendor.
76. Në rastin konkret, Gjykata Themelore ka analizuar në hollësi të madhe marrëdhëniet në mes N.V., si personi që ka bërë transfere të shumave të caktuara nga C.B.E. në P. SHPK, Q. LB, K. SHPR dhe N.B. (*shih* faqet 124 deri në 132, dhe 135 deri në 139 të Aktgjkimit PKR. Nr. 1046 / 13). Në veçanti, Gjykata Themelore erdhi në përfundim se të dhënat telefonike dëshmojnë se N.V. dhe F.B. kishin lidhje telefonike me E.D.. Më tej, është vërtetuar se nuk ka pasur marrëveshje me shkrim ndërmjet C.B.E.-së dhe E.D. për të dhënë "kredi" ose diskutim për të shlyer "kredi". Për më tepër, paratë nuk kanë raportuar në llogaritë e P. SHPK- së ose të deklarohen për qëllime tatimore. Në lidhje me N.T., Gjykata Themelore erdhi në përfundim se F.B. dhe N.T. ishin miq dhe bashkëpunëtorë të biznesit. Informacionet e marra nga përgjimet e ligjshme kanë treguar se F.B. madje kishte komunikuar me N.T. në ditën e arrestimit të tij. Prandaj, Kolegji konstaton se kjo tregon qartë njohuritë e të pandehurve në lidhje me prejardhjen e paligjshme të parave dhe qëllimin e tyre për të fshehur natyrën, burimin dhe pronësinë e tyre. Elementet subjektive të veprës penale të pastrimit të parave janë vërtetuar plotësisht nga Gjykata Themelore.
77. Kolegji është i ndërgjegjshëm që aktgjkimi i Gjykatës Themelore nuk e trajton çdo element të veprës penale të pastrimit të parave veç e veç; megjithatë aktgjkimet duhet të lexohen në tërësinë e tyre, duke përfshirë dispozitivin dhe të gjitha pjesët e arsytimit. Në rastin në fjalë, është e dukshme nga aktgjkimi i Gjykatës Themelore që çdo element i veprës penale të

pastrimit të parave është vërtetuar plotësisht, dhe më tej është konfirmuar nga Gjykata e Apelit. Prandaj, Kolegji konsideron se mospajtimi i të pandehurve me gjendjen e vërtetuar faktike nuk përbën shkelje të ligjit penal, siç përshkruhet në nenin 432 (1.1) të KPP-së. Si e tillë, pretendimet se nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale të pastrimit të parave, refuzohen si të pabazuara.

#### *Llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim*

78. Avokati mbrojtës i N.V. parashtron se Gjykata e Apelit ka shkelur ligjin penal, siç përcaktohet në nenin 385 (1.6) të KPP-së, gjatë akreditimit të kohës së kaluar në paraburgim ndaj dënimit. Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar e ka akredituar kohën e kaluar në paraburgim nga 14 nëntori 2014, gjersa N.V. ishte në paraburgim që nga 14 nëntori 2012.

79. Kolegji konsideron se ky është gabim *de minimum*, një gabim shkrimi dhe gabim në llogaritje, ashtu siç përshkruhet në nenin 371 të KPP-së. Më tej, Kolegji thekson se i njëjti gabim *de minimum* është bërë në lidhje me të pandehurit F.B. dhe B.B.. Gabimi i tillë nuk përbën shkelje të ligjeve në lidhje me kreditimin e periudhës së paraburgimit, siç përshkruhet në Nenin 385 (1) (1.6) të KPP-së. Prandaj, pretendimi i mbrojtjes refuzohet si i pabazuar.

80. Megjithatë, në bazë të nenit 438 (1) (1.1) të KPP-së dhe sipas parimit *beneficium cohaesionis* i përcaktuar në nenet 397 dhe 436 (2) të KPP-së, Kolegji e ka modifikuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR 216/ 15, faqe 7, paragrafi IV siç vijon: "Në bazë të nenit 365 par 1.5 të KPP-së, koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, respektivisht, është kredituar ndaj të pandehurve; për N.V. nga 12 nëntori i vitit 2012, për F.B. nga 12 nëntori i vitit 2012, për B.B. nga 12 nëntori i vitit 2012, për E.D. nga 18 dhjetori 2014, për I.F. nga 18 dhjetori 2014 deri më 25 dhjetor 2014, dhe për N.T. nga 18 dhjetori 2014 deri më 25 dhjetor 2014".

#### *Shkeljet në përcaktimin e dënimit*

81. Avokati mbrojtës i E.D. pohon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale të parashikuara në nenet 432 (1.2), dhe 384 (1.12) në lidhje me nenin 370 (8) të KPP-së, sepse aktgjykimi nuk përmban arsyetimin e duhur të sanksionit penal. Mbrojtja argumenton se i pandehuri duhej të kishte marrë një dënim të butë.
82. Kolegji thekson se rrethanat rënduese dhe lehtësuese në caktimin e dënimit të duhur janë trajtuar në hollësi të madhe nga Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj (*shih* faqet 168 deri në 169 të Aktgjykimit PKR. Nr. 1046 / 13). Aktgjykimi iu ka referuar rrethanave personale në lidhje me të pandehurit, në veçanti gjendjen e tij familjare. Gjykata Themelore më tutje i mori parasysh rrethanat lidhur me rastin, mënyrën në të cilën është kryer vepra penale dhe pasojat e konsiderueshme të veprës penale. Gjykata e Apelit e shqyrtoi vlerësimin e Gjykatës Themelore dhe arriti në përfundimin se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm. Megjithatë, Gjykata e Apelit theksoi se përfshirja e secilit të pandehur në vepër penale ishte i nivelit të ndryshëm, dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe, në interes të administrimit të drejtësisë, e ka zvogëluar dënimin e E.D. nga dënimi prej 8 (tetë) viteve burgim dhe një gjobe prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, që duhej paguar brenda 6 (gjashtë) muajve pasi aktgjykimi të merrte formën e prerë, në 5 (pesë) vite burgim dhe një gjobë prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) eurosh.
83. Kolegji pajtohet me arsyetimin e Gjykatës së Apelit dhe arrin në përfundimin se pjesëmarrja individuale në veprën penale është vlerësuar plotësisht dhe dënimi ishte përshtatur në përputhje me këtë. Dënimi pasqyron qëllimin e dënimit të parashikuar me ligj, pasojat e konsiderueshme për shoqërinë dhe nivelin e pjesëmarrjes së secilit të pandehur. Prandaj, pretendimi i mbrojtjes se dënimi i shqiptuar ndaj E.D. duhet të jetë më i butë, refuzohet si i pabazuar.
84. Mbrojtja e N.T. pretendon se gjykatat kanë shkelur ligjin penal, për shkak se ata nuk arritën të japin arsyet për dënimin.
85. Kolegji thekson se pretendimi i mbrojtjes në lidhje me bazën e dënimeve është tërësisht i lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike të rastit. Kolegji thekson se në bazë të nenit 432 (2) të KPP-së kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike (çështja është e detajuar në paragrafët 56 deri në 60

të këtij aktgjykimi). Prandaj, Kolegji konsideron se mbrojtja nuk arriti të tregojë ndonjë arsye që përmendet në Nenin 432 (1) të KPP-së, dhe e hedh poshtë pretendimin, se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk i kanë dhënë arsyet për dënimin, si të pabazuar.

#### *Urdhri i konfiskimit*

86. Mbrojtja e N.V. pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk përmban asnjë arsyetim lidhur me konfiskimin e pasurisë, siç është përcaktuar në Urdhrin PKR.Nr.1046 / 13 të datës 18 dhjetor 2014. Urdhri i dhënë në pajtim me nenin 284 të KPP-së nuk e zvogëlon detyrimin për të dhënë arsyetimin në aktgjykim gjithashtu. Mbrojtja më tej pohon se urdhri për konfiskim është i pabazuar dhe në kundërshtim me ligjin, që përbën shkelje të ligjit penal sipas nenit 385 (1) (1.5) të KPP-së. E pandehura N.V. bleu apartament me paratë e fituara në mënyrë të ligjshme, veçanërisht nga pagesa që ajo mori për shërbimet e saj për OeSD-në.
87. Kolegji thekson se në bazë të nenit 284 (1) të KPP-së, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, së bashku me aktgjykimin lëshon edhe urdhrin e arsyetuar që përcakton nëse duhet të konfiskohen apo të lirohen pasuritë e përcaktuara në aktakuzë. Neni 275 (1) i KPP-së thotë se gjykata mund të lëshojë urdhër përfundimtar për konfiskimin penal vetëm pasi të vërtetohet se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti ka qenë dobi pasurore e veprës penale. Është e përcaktuar në nenin 276 (3) të KPP-së, se prona që është blerë me mjetet e përfituara drejtpërdrejt nga veprimet që përbëjnë vepër penale është dobi pasurore e fituar me atë vepër penale.
88. Kolegji thekson se ligji tregon qartë se urdhri për konfiskimin penal lëshohet ndaras nga aktgjykimi dhe duhet të jetë në harmoni me konstatimet e aktgjykimit. Ky ishte qëllimi i ligjvënësit, që të ndajë çështjen e konfiskimit penal nga aktgjykimi kryesor. Prandaj, Kolegji konstaton se Gjykata Themelore ka vepruar sipas kushteve të përcaktuara në nenet 274 - 284 të KPP-së në lidhje me procedurën e konfiskimit penal.
89. Në rastin konkret, Gjykata Themelore ka lëshuar Urdhrin për Konfiskim, i cili ishte në harmoni me aktgjykimin në të njëjtin rast. Në mënyrë të qartë është vërtetuar në aktgjykimin e Gjykatës Themelore se banesa e përmendur në hollësi në pikën I.a të Urdhrit për Konfiskim

ishite blerë, duke shfrytëzuar fondet që ishin fituar drejtpërdrejtë, për shkak të veprimeve që përbëjnë veprën penale. Gjykata Themelore konstatoi se paratë për blerjen e banesës ishin transferuar nga llogaria e C.B.E.-së, dhe jo nga fondet personale të N.V., siç pretendohet nga mbrojtja. Prandaj, Kolegji është i kënaqur që Gjykata Themelore konstatoi në mënyrë të saktë se banesa ishte blerë nga e pandehura me të hollat e fituara në mënyrë të paligjshme nga MPB-ja.

90. Akuzat e avokatit mbrojtës se Urdhri për Konfiskim nuk është arsyetuar sa duhet dhe është i pabazuar dhe në kundërshtim me ligjin, që përbën shkelje të ligjit penal sipas nenit 385 (1) (1.5) të KPP-së, refuzohet si i pabazuar.

## **VI. PËRFUNDIM**

91. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË**

**PML-178/16**

**Kryetar i trupit gjykues:**

**Procesmbajtëse:**

---

Avdi Dinaj

**Gjyqtar i Gjykatës Supreme**

---

Sandra Gudaityte

**Zyrtare ligjore e EULEX-it**

**Anëtarë të trupit gjykues:**

---

Anna Adamska-Gallant  
**Gjyqtare e EULEX-it**

---

Nebojsa Boricic  
**Gjyqtar i Gjykatës Supreme**